

VENDIM
Nr.227, datë 23.3.2011

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 175, DATË 13.2.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE
DHE KULLOTA, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË KOMUNËS HORË-
VRANISHT TË QARKUT TË VLORËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.175, datë 13.2.2008 të Këshillit të Ministrave, të shtohet edhe lista e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 11 (njëmbëdhjetë) fletë, që përfundon me numrin rendor 402 (katërqind e dy), e që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Lista shtesë e pyjeve dhe kullotave, si dhe tabela me lidhjen numër 1 (një) i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe njësia e qeverisjes vendore Horë-Vranisht të qarkut të Vlorës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha